

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 18559/20

XHEZAIR ZAGANJORI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 3 mars 2026, si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Diana Kovatcheva,

Canòlic Mingorance Cairat, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 18559/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 28 prill 2020 nga shtetasi shqiptar z. Xhezair Zaganjori (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1957, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. A. Toslluku, avokat i licencuar në Tiranë;

tërheqjen e z. Darian Pavli, gjyqtar i zgjedhur për Shqipërinë, për të mos gjykuar çështjen (Rregulli 28 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm Shtetit, për ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës private dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra sipas ligjit për vetingun (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese që në vitin 2003. Në vitin 2013 ai u emërua në Gjykatën e Lartë dhe shërbeu si kryetar i saj.

3. Më 24 korrik 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) konfirmoi kërkuesin në detyrë sipas të tre komponentëve të procesit të vetingut (vlerësimi i pasurisë, vlerësimi i pastërtisë së figurës dhe vlerësimi profesional). Edhe pse ai identifikoi disa parregullsi dhe mospërputhje në lidhje me vlerësimin e pasurive, vlerësoi që ato nuk e përlligjnin shkarkimin e tij nga detyra.

4. Komisioneri publik e ankimoi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (“KPA”), në lidhje me vlerësimin e pasurisë.

5. KPA-ja zhvilloi disa seanca dhe rishyrtoi çështjen në bazë të parashtrimeve të Komisionerit publik dhe kërkuesit dhe provave të paraqitura prej tyre. Me vendim të 26 korrikut 2019, KPA-ja përmbysi njëzëri vendimin e KPK-së dhe e shkarkoi kërkuesin nga detyra, sipas nenit 61 (3) të ligjit për vetingun. Ai u shpreh si më poshtë:

6. Më datë 6 korrik 2006, sipas kontratës së shitjes, kërkuesi kishte blerë një apartament në Durrës me çmim 32.000 USD dhe pagesa ishte bërë jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën e tij të vitit 2006, ai ka deklaruar tërheqje të shumës prej 1.250.000 lekësh pranë Bankës Italo-Shqiptare në muajin maj 2006. Në deklaratën e vetingut, burimi i kësaj pasurie është raportuar si të ardhura personale dhe nga qiraja. Gjatë procesit të vetingut, ai ka shpjeguar se shuma 16.000 USD ishte tërhequr nga një depozitë në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Ai ka deklaruar se llogaria në atë bankë ishte çelur me shumën 16.000 USD dhe më pas e ka shtuar me 15.000 USD në vitin 2004 dhe 16.000 USD në vitin 2005. Llogaria në bankën Italo-Shqiptare ishte çelur me 1.200.000 lekë. Më tej ai u shpreh që shuma prej 16.000 USD: “*duhet*

të jetë dhënë në fillim të vitit 2006”. Megjithatë, kërkuesi kishte bërë një deklaram të pasaktë duke pretenduar që 16.000 USD ishin tërhequr nga llogaria në Bankën Amerikane të Shqipërisë për të financuar blerjen. Të dhënat bankare tregonin që llogaria përkatëse e depozitës e çelur në dhjetor 2004 me 16.093 USD ishte shtuar në 31.576 USD në dhjetor 2005 dhe kishte mbetur e pandryshuar deri në vitin 2008, duke rezultuar pa asnjë tërheqje. Depozita prej 1.200.000 (ekuivalente me përafërsisht 12.000 USD) nga llogaria e çelur në Bankën Italo-Shqiptare në vitin 2004 ishte tërhequr në prill 2006.

7. Kërkuesi kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet në vitin 2011, me vlerën 455.199 lekë (përafërsisht 3,275 euro (EUR)), por i mungonte aftësia financiare për të bërë të njëjtën gjë në vitin 2012 në shumën 1.402.445 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 1.530.109 lekë (përafërsisht 21.000 EUR gjithsej). Për të dalë në këtë konkluzion, KPA-ja zbriti shpenzimet zyrtare të kërkuesit në shumën 5.207 EUR nga llogaritjet, të lidhje me shpenzimet familjare. KPA-ja rrëzoi pretendimin e kërkuesit që kishte deklaruar çdo vit dhe që kishte pasur 900.000 lekë (përafërsisht 6,450 EUR) para fizike në vitet 2012 dhe 2014. Edhe pse ai ka deklaruar 300.000 lekë në vitin 2003 dhe 600.000 në vitin 2004, nuk ka deklaruar asnjëherë ndonjë ndryshim më pas, pavarësisht nga detyrimi ligjor për të deklaruar shtesat ose zbritjet në shumën e parasë fizike çdo vit. Në deklaramet vjetore të mëpasshme, ose në deklaramet e vetingut, nuk u shfaq asnjë gjurmë e asaj shume.

8. Kërkuesi bëri deklaram të pasaktë në lidhje me shpenzimet e tij për shkollimin dhe jetesën e dy familjarëve të tij jashtë vendit.

a) Gjatë procesit të vetingut ai ka deklaruar shuma të ndryshme për periudhën 2008–2014. KPA-ja i pranoi përgjithësisht ato shuma si të konfirmuara nga transaksionet bankare (me sa duket të depozituara në llogaritë e atyre familjarëve), të cilat arrinin në shumën 82.000 GBP për periudhën 2008–2023 – duke përfshirë 17.386 GBP për vitin 2010 dhe 20.565 GBP për vitin 2011 – si edhe 12.024 EUR për vitin 2014. Megjithatë, KPA-ja vlerësoi se kishte mospërputhje të konsiderueshme – 1.700 GBP për vitin 2008, 4.886 GBP për vitin 2010, 7.365 GBP për vitin 2011 dhe 2.977 EUR për vitin 2014 – krahasuar me shumën më të vogla të deklaruar në deklaramet vjetore për të njëjtat shpenzime gjatë këtyre viteve. Vlerësimi i pasurisë në kuadër të procesit të vetingut përfshinte vlerësimin e deklaramave vjetore për të përcaktuar nëse subjekti i vetingut ka bërë deklaram të pasaktë, ka fshehur pasuritë ose ka bërë një deklaram të rremë gjatë viteve të mëparshme. Ndonëse nuk është një faktor i izoluar për të dalë në konkluzion mbi pamjaftueshmërinë e deklaramit dhe shkarkimin nga detyra, vlerësimi i përgjithshëm i deklaramit të vetingut, duke e krahasuar me deklaramet e mëparshme mundësoi vlerësimin e vërtetësisë së deklarameve të subjektit të vetingut dhe nxjerrjen e konkluzioneve mbi ligjshmërinë e pasurisë ose mjaftueshmërinë e deklarameve gjatë viteve, sidomos meqë deklaramet vjetore përmbanin deklaramet të kohës për transaksionet. Në fund, u vërejt se diferenca e lartpërmendur për vitin 2014, gjithashtu, e tejkaloi kufirin ligjor për shpenzime që duhej të ishin deklaruar në atë kohë dhe u konsiderua që nuk ishte deklaruar.

b) Kërkuesi nuk kishte paraqitur dokumente për të provuar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së një familjari të tij jashtë vendit në periudhën 2008-13 (shihni (a) më sipër), ku kërkuesi, gjithashtu, kishte një deficit për vitin 2012 (shihni paragrafin 7 më sipër). KPA-ja refuzoi pretendimin e kërkuesit që kishte qenë e vështirë të siguronte faturat për shkak të kohës së konsiderueshme që kishte kaluar. Ai nuk paraqiti asnjë dokument apo provë për të treguar përpjekjet e bëra për të siguruar këto të dhëna ose për të provuar zhdukjen, humbjen e tyre ose pamundësinë për t’u rikrijuar ose siguruar me mënyra të tjera, duke rezultuar në pamundësinë objektive të paraqitjes së tyre (siç e kërkon nenin 32 (2) i Ligjit për Vetingun).

9. KPA gjithashtu vlerësoi: a) se kërkuesi kishte bërë një deklaram të pasaktë për shkak se shumën e deklaruar prej tij – në deklaramin e vetingut dhe në deklaramin e vitit 2003 – si investimi i tij për ndërtimin e një objekti në periudhën 1997-99 ishin të ndryshme dhe për shkak se të ardhurat e tij të pretenduara nga dhënia me qira e një pjese të objektit nuk mund të financonin pjesën tjetër, sepse të dyja ishin blerë në të njëjtën kohë sipas kontratës së blerjes në vitin 2001 dhe prandaj deklarami i tij i vitit 2003 ishte i pasaktë; b) se ai nuk kishte provuar

që shuma 6.698.384 lekë për atë investim buronte nga kursimet e tij; c) se ai nuk kishte justifikuar burimet e ligjshme – përfshirë të ardhurat nga qiraja – shpenzimet e kryera gjatë gjysmës së parë të vitit 2006 dhe kishte një diferencë prej 458.761 lekë (përafërsisht 3700 EUR), sidomos për financimin e apartamentit të lart përmendur në Durrës; ai vetëm ishte bërë bashkëpronar i disa ambienteve në objektin e lart përmendur sipas kontratës së blerjes në vitin 2001, nuk kishte qenë pjesë e ndonjë kontrate qiraje për ato hapësira deri në shkurt 2003 dhe nuk kishte paraqitur provë të mjaftueshme për pagesën e tatimit për të ardhurat nga qiraja deri në vitin 2007; dhe d) që dokumentet e paraqitura nga kërkuesi nuk provonin plotësisht që akomodimi dhe shpenzimet e shkollimit të anëtarit të dytë të familjes së tij jashtë vendit justifikonin shpenzimet e deklaruar nga kërkuesi për vitin 2014-17.

10. Rezulton kërkuesi ka marrë tekstin e plotë të vendimit të KPA-së me *email* më 25 tetor 2019 dhe me postë në një datë të paspecifikuar.

11. Kërkuesi u ankua sipas nenit 8 të Konventës që shkarkimi i tij nga detyra kishte qenë arbitrar dhe shproporcional, sepse bazohej në parregullsi ose mospërputhje të vogla.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Objekti i çështjes

12. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi përfshiu disa pretendime të reja për herë të parë, sidomos që trupi gjykues i KPA-së nuk ishte “krijuar me ligj”, për shkak të moskualifikimit të pretenduar të L.D. për t’u emëruar si gjyqtar i KPA-së. Këto pretendime nuk janë shtjellim i ankimit fillestar të komunikuar që kishte të bënte me shkaqet për shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Prandaj ajo janë jashtë objektit të çështjes në fjalë (shihni *Kulák kundër Sllovakisë*, nr. 57748/21, § 52, 3 prill 2025).

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

a) Qeveria

13. Qeveria rikonfirmoi gjetjet dhe konkluzionet e KPA-së. Shkaqe për shkarkimin e kërkuesit – bazuar në problemet me të ardhurat nga qiraja, mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet për vitin 2012 dhe 2014 dhe blerjen e një apartamenti – kishin të bënin me periudhën kur ai kishte shërbyer si gjyqtar dhe për të cilën ai kishte paraqitur deklaratimet që në vitin 2003. Kërkuesi nuk ka specifikuar ndonjë standard alternativ për llogaritjen e shpenzimeve për periudhën 2012-14 që do të ishte më i saktë ose i përshtatshëm për situatën e tij dhe nuk ka dhënë llogaritje të sakta të tepricave të pretenduara si të gjeneruara gjatë asaj kohe për të treguar se vlerësimi i bërë nga KPA-ja, në lidhje me shpenzimet e tij kishte qenë i pasaktë ose i paarsyeshëm. KPA-ja kishte identifikuar mospërputhje, në lidhje me një lloj specifik të shpenzimeve në disa deklaratime ndërmjet 2008 dhe 2014.

b) Kërkuesi

14. Kërkuesi pretendoi se ishte shkarkuar nga detyra për mospërputhje ose parregullsi të vogla të bëra përpara vitit 2003, kur ishte bërë gjyqtar, dhe jo për ndonjë shkelje të rëndë, siç është deklarimi i rremë ose fshehja e pasurisë. Nuk kishte të dhëna për stil jetese të ekzagjeruar dhe nuk kishte vepruar asnjëherë në keqbesim kur kishte paraqitur deklaratimet e pasurisë.

15. Kontrata e blerjes e vitit 2006 dhe fondet për të ishin deklaruar rregullisht në deklaratimin vjetor. 40% e shumës ishte tërhequr nga banka dhe i ishte paguar shitësit. KPA-ja kishte vërejtur që kërkuesi nuk mund të ofronte prova të tjera, për shkak se kishte kaluar një kohë e konsiderueshme. Të ardhurat e familjes së tij në vitin 2005 dhe 2006 të marra veçmas e mbulonin plotësisht shumën e paguar për apartamentin. KPA-ja nuk e kishte marrë këtë gjë parasysh në mënyrë të paarsyeshme dhe kishte keqinterpretuar faktet dhe provat e paraqitura, duke mos arritur që të japë arsye për interpretimin e ndryshëm.

16. Metodologjia e përdorur për të llogaritur shpenzimet vjetore për vitin 2012 dhe 2014 kishte qenë e pasaktë. Të ardhurat dhe kursimet e mëparshme të familjes së tij duhej të ishin vlerësuar. Në deklaratimet e tij vjetore ai kishte treguar një tepricë prej 3.200.000 lekësh në vitin 2011 dhe 3.900.000 lekësh në vitin 2013 dhe shumë në para fizike për shpenzime në raste

emergjence. Gjithashtu, shpenzimet e lidhura me punën që i kishte paguar me kartën e tij të kreditit i ishin rimbursuar.

17. Kërkuesi pretendoi se nuk ishte pyetur asnjëherë më parë për deklaratimet e tij vjetore. Kur u pyet gjatë procesit të vetingut, ai sqaroi me detaje të gjitha pagesat dhe paraqiti të gjitha dokumentet e transfertave bankare që në vitin 2008. Kishte disa mospërputhje në lidhje me shpenzimet për studimet e një familjari jashtë vendit, për shkak të “mungesës së metodologjisë” në deklarinimin vjetor të kërkuesit për periudhën 2009-11. Megjithatë, ai e sqaroi situatën në deklarinimin e vetingut dhe paraqiti të gjitha provat në dispozicion. Duke pasur parasysh kohën e konsiderueshme që kishte kaluar, ai, apo familjarët e tij, nuk i kishin mbajtur të gjitha faturat në lidhje me shpenzimet e kryera, sepse nuk kishin dijeni që ato do të kërkoheshin në vitin 2017 për procesin e vetingut. Objektivisht kishte qenë e pamundur që të siguroheshin të gjitha këto dokumente dhe disa pasaktësi ishin të pashmangshme. Sidoqoftë, asnjë gjë nuk ishte fshehur dhe të gjitha shpenzimet ishin mbuluar plotësisht me të ardhurat e siguruar nga kërkuesi dhe bashkëshortja e tij gjatë atyre viteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

18. Shkarkimi i kërkuesit nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private (shihni *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, §§ 135 dhe 137, 4 korrik 2023). Kërkuesi e pranoi që ndërhyrja kishte qenë në përputhje me ligjin dhe qëllimet legjitime të ndjekura (shihni edhe *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 75 dhe 79, 13 dhjetor 2022), por pretendoi që kishte qenë shproporcionale.

19. Komisioneri Publik ankoi konkluzionet e KPK-së vetëm në lidhje me elementin e parë të procesit të vetingut (shihni paragrafët 4 dhe 5 më sipër). KPA-ja e bazoi shkarkimin e kërkuesit nga detyra në nenin 61 (3) të ligjit për vetingun dhe gjeti një deficit në vitin 2012 dhe 2014. Gjithashtu, vërejtje që ai kishte bërë deklaratime të paplota, të pasakta në lidhje me: i. shumat për sponsorizimin e shpenzimeve të familjarëve të tij jashtë vendit gjatë disa viteve; dhe ii. burimin për financimin e blerjes së një apartamenti në vitin 2006. Gjykata do të trajtojë më poshtë ankimet për këto gjetje, që gjithashtu kishin të bënin me kohën kur kërkuesi kishte qenë gjyqtar i lartë dhe subjekt i kërkesave të ligjit të vitit 2003 për deklarinimin e pasurisë.

20. Në lidhje me gjetjet e KPA-së, të përmendura më sipër, bazuar në nenin 6 të Konventës, kërkuesi pretendoi që kishte mangësi procedurale në vendimin që rezultoi në shkarkimin e tij nga detyra. Këto ankime ishin shpallur të papranueshme në kohën e komunikimit të kësaj kërkesë. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi rikonfirmoi disa nga ato ankime, sipas nenit 8. Gjykata nuk ka identifikuar mangësi të rënda në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit në nivel kombëtar u nxorën konstatimet e mësipërme dhe nuk sheh arsye për të dalë në një konkluzion të ndryshëm për pranueshmërinë e atyre pretendimeve, sipas nenit 8 (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 158).

21. Së dyti, në lidhje me proporcionalitetin, kërkuesi në thelb pretendoi se gjetjet e KPA-së për pikat e shprehura në paragrafin 19 më sipër ishin arbitrare dhe të paarsyeshme. Siç janë paraqitur, këto pretendime mbeten të paprovuara dhe konkluzionet e KPA-së nuk duket se arrijnë kufirin e arbitraritetit apo mungesës së dukshme të arsyes (shihni *Yüksel Yalçınkaya kundër Turqisë* [DHM], nr. 15669/20, § 304 *in fine*, 26 shtator 2023, dhe *Xhoxhaj*, cituar më lart, § 407). Në veçanti, Gjykata vëren se KPA ka dhënë arsye për rrëzimin e pretendimeve të kërkuesit në lidhje me aftësinë e tij financiare për vitet 2012 dhe 2014. Njëkohësisht, ai nuk ka paraqitur ndonjë element apo provë bindëse që do të tregonte ndonjë gabim ligjor apo faktik të dukshëm në arsyetimin, llogaritjet ose metodën e KPA-së (shihni *Jaupi kundër Shqipërisë*, nr. 23369/16, § 119, 29 prill 2025, dhe krahasoni *Sevdari*, cituar më sipër, § 96).

22. Prandaj, Gjykata do të vlerësojë pretendimin fillestar për shproporcionalitetin në bazë të fakteve siç u përcaktuan dhe vlerësuan nga KPA-ja.

23. Kërkuesi u shpreh se një pjesë e konsiderueshme e fondeve të përdorura për të blerë apartamentin në vitin 2006 (16.000 USD, e pretenduar e mbledhur nga kursimet që rrjedhin nga të ardhurat e punësimit dhe qirasë) ishte tërhequr nga një llogari në Bankën Amerikane të Shqipërisë. KPA-ja vendosi që nuk ishte bërë tërheqje nga ajo llogari gjatë periudhës përkatëse.

Shuma e tërhequr nga një llogari në një bankë tjetër nuk dukej e mjaftueshme për të shpjeguar deklarimin e pasaktë. Një deklarim i saktë dhe i provuar për burimin thelbësor të një pasurie të konsiderueshme dhe lëvizja e fondeve të mëdha, në lidhje me atë – pagesë me para fizike pas një tërheqjeje bankare ose përmes transfertës bankare – ishte thelbësore për të siguruar gjurmueshmërinë dhe për të verifikuar ligjshmërinë e origjinës së fondeve dhe aspekte të tjera të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së këtyre fondeve. Kërkuesi nuk arriti të jepte shpjegim të besueshëm (shihni paragrafët 6 dhe 15 më sipër).

24. Shumat e deklaruara rishtazi dhe të pranuar gjatë procesit të vetingut, për viten 2010, 2011 dhe 2014, ishin mjaft më të larta se ato të raportuara për të njëjtin lloj shpenzimi të përsëritur në deklarimet vjetore përkatëse. Këto diferenca kishin të bënin me disa vite dhe nuk ishin të vogla, si në terma absolutë, ashtu edhe në raport me madhësinë e shpenzimeve. Për shembull, shuma e diferencës për vitin 2014 e tejkalonte kufirin ligjor për shpenzimet që duheshin dekluarar (shihni paragrafin 8 (a) më sipër dhe *Thanza*, përmendur më sipër § 68). Gjithashtu, Gjykata vëren se në vitin 2014 kishte një deficit vjetor të përgjithshëm (shihni paragrafin 7 më sipër). Ndonëse u paraqit dokumentacion, në lidhje me veprimtarinë e llogarisë bankare, të marra së bashku me veprime të ngjashme për vitet e tjera, ky kontekst kërkonte vlerësim të kujdesshëm të saktësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve. Këto mospërputhje nuk ishin shpjeguar si duhej.

25. Gjithashtu, kërkuesi nuk arriti të provojë shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për një anëtar të familjes, që i korrespondojnë shumave të cilat rezultojnë nga veprimtaria bankare në periudhën 2008-13 (shihni paragrafin 8 (b) më sipër). Mes palëve nuk ka pasur mosmarrëveshje që kërkesa për të vërtetuar shumën aktuale, të paktën, të kategorive kryesore të atij shpenzimi madhor (mbi 82,000 GBP, shihni paragrafin 8 (a) më sipër) – për shembull, akomodim ose shkollim – ishte në përputhje me qëllimet legjitime të procesit të vetingut. Gjithashtu, duket se sipas ligjit për deklarimin e pasurisë 2003, mund të pritej që kërkuesi të mbante dokumentet përkatëse (shihni *Xhoxhaj*, cituar më lart, §§ 201-03). Sidoqoftë, ai nuk tregoi se kishte marrë masa për të siguruar ato dokumente gjatë procesit të vetingut, ndërsa e kishte bërë këtë gjë për vitet vijuese (shihni paragrafin 9 (d) më sipër).

26. Deficitet e përgjithshme vjetore të identifikuar për 2012 dhe 2014 ishin objektivisht të konsiderueshme (shihni paragrafin 7 më sipër). Pretendimi i kërkuesit që të ardhurat në dispozicion të familjes së tij brenda periudhës 2011 deri në 2014 tejkalonin në masë të konsiderueshme shpenzimet e përgjithshme për atë periudhë nuk është provuar dhe nuk rrëzon konkluzionet e KPA-së në lidhje me dy vite specifike. Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument apo provë bindëse për të kundërshtuar, shpjeguar ose justifikuar këto deficite (shihni paragrafët 16 dhe 21 më sipër).

27. Nëse gjykatat e brendshme kanë shqyrtuar me kujdes faktet, kanë zbatuar standardet e të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe praktikën gjyqësore, dhe kanë balancuar si duhet interesin personal me interesin publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj me atë të gjykatave të brendshme (shihni *Halet kundër Luksemburgut* [DHM], nr. 21884/18, § 161, 14 shkurt 2023). Duke i marrë së bashku faktorët e lartpërmendur dhe duke vërejtur pozicionin e kërkuesit si gjyqtar i lartë, i cili ka mbajtur pozicionin më të lartë në sistemin gjyqësor gjatë procesit të vetingut (shihni *Xhoxhaj*, përmendur më lart, § 407 *in fine*) arsyet e dhëna prej tij janë të pamjaftueshme që Gjykata të devijojë nga konkluzionet e KPA-së dhe, në terma të përgjithshëm, të ndikojë në rezultatin e çështjes së vetingut. Prandaj, Gjykata nuk gjen që shkarkimi i tij nga detyra ka qenë shproporcional.

28. Nisur nga ky konkluzion, nuk është e nevojshme që Gjykata të bëjë një shqyrtim të detajuar të gjetjeve dhe konkluzioneve të tjera të KPA-së (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 160).

29. Në këto rrethana, ankimi sipas nenit 8 është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimitisht:

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 26 mars 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Peeter Roosma
KRYETAR